



**Datë:** 06.03.2025

**Numër Protokoli:** 1604/2025

**A.nr.143/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtare, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.143/2025 të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.K , kundër Njoftimit të datës 24.12.2024 të Komisionit të Pranimit në Inspektoratin e Punës ne çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ e filluar sipas ankesës A.nr.143/2025, të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, A.K.

## A r s y e t i m

Ankuesi A.K(në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), kandidat për pranim në shërbimin civil sipas Konkursit Nr. Reference: RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektoratit i Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, sepse:

Nga provat e administruara, rezulton se Inspektorati i Punës ka shpallur Konkursin me datë 13.09.2024 me Nr. referencës RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, klasa profesional 1, numri i kërkuar 7, me afat aplikimi nga data 14.09.2024 deri më datë 13.10.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, ndërsa Komisioni i Pranimit në Inspektoratin e Punës ka publikuar Njoftimin me datën 24.12.2024 për kandidatet fitues, për pozitën “Inspektor i Punës “Rajoni i Prizrenit.

Kundër Njoftimit Njoftimin te datës 24.12 2024 të Komisionit të pranimit në Inspektoratin e Punës ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 21.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesë, thekson faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.74/2025, , dhe për pasojë është anuluar Konkursi me numër Nr. Reference: RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektoratit i Punës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.74/2025, , është anuluar Konkursi me numër Reference: RN00015136 për grupin e administrimit të përgjithshëm pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Prizrenit, i shpallur nga Inspektoratit i Punës, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë. Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.143/2025, të datës 21.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.143/2025

**Ylber Fetahaj**

Procesmbajtës

**Malsore Gashi-Bajraktari**

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit; A.K ;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së